



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE PROCEDURALE, LIGJORE DHE MARRËDHENIEVE ME JASHTË
Nr. 59 Prot. Tiranë, më 20/01/2014

Lënda: Dërgohen propozime mbi Projekt Kodin e Transmetimit.

Drejtuar: Znj. Endirë BUSHATI
KRYETARE
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

TIRANË

E nderuar znj. Bushati,

Në vijim të shkresës Tuaj nr.59 Prot., datë 10.01.2014, me anë të së cilës kërkohet mendim për Projekt Kodin e Transmetimeve, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, pasi u njoh me këtë material, ka përgatitur disa propozime në përputhje me fushën e veprimtarisë së tij dhe Ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Propozimet për shtesa ose ndryshime për pikat e Projekt Kodit të Transmetimit, janë të pasqyruara si më poshtë sipas seksioneve:

Në seksionin 1 “**Parimet Themelore**” pika 1.12 të riformulohet si më poshtë:

1.12. “*Transmetimet audiovizive të të gjitha llojeve të respektojnë parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit për çdo shkak të mbrojtur nga legjislacioni shqiptar.*”

Në seksionin 2 “**E drejta për privatësi**” propozojmë të shtohet:

2.12. “*Në Transmetimet audiovizive, respektimi i parimit të privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale duhet të zbatohet pa diskriminuar për shkaqe si raca, mosha, aftësia e kufizuar ose çdo shkak tjetër të mbrojtur nga legjislacioni shqiptar.*”

Në seksionin 4 “**Transmetimi i Programeve Informative**” pika 4.11 shkaqet e diskriminimit të jenë në përputhje me nenin 1 të Ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ku parashikohet një listë jo shteruese shkaqesh:

4.11. “*Transmetimet audiovizive informative nuk duhet të përmbajnë në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose të nënkuptojnë mesazhe diskriminuese për shkaqe si: gjinia,*



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

raca, ngjyra, etnia, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore ose çdo shkak tjetër.”

Në seksionin 4 të shtohet pikat si më poshtë:

4.20. *“OSHMA-të në hapësirën informative, nuk duhet të keqpërdorin grupet vulnerabël, por duhet promovuar një qasje pozitive ndaj grupeve vulnerabël (minoriteteve, grave të dhunuara, personave me aftësi të kufizuar etj.)”*

Në Seksionin 5 **“Fëmijët në transmetimet Audiovizive”** të shtohet:

5.41. *“Në programet kulturore e argëtuese për fëmijët nuk duhet të përdoren terma të cilat nxisin qëndrime paragjyquese.”*

Në seksionin 6 **“Personat me Aftësi të Kufizuar në transmetimet Audiovizive”**, të shtohet:

6.9. *“OSHMA duhet të garantojnë që shërbimet e tyre të jenë të aksesueshme nga personat me aftësi të kufizuar. OSHMA duhet të nxisin promovimin e arritjeve të personave me aftësi të kufizuar.”*

Në Seksionin 8 **“Reklamat në Transmetimet Audiovizive”** pika 8.3 të riformulohet në përputhje me Ligjin nr. 10 221 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*:

8.3. *“Ndalohet publikimi i reklamave, nëse ato paraqesin, haptazi apo në mënyrë të nënkuptuar, qëllim për të diskriminuar për shkaqe të mbrojtura nga legjislacioni shqiptar.”*

Duke besuar në bashkëpunimin Tuaj,



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al